

URDHËR
Nr. 135, datë 16.4.2015

**PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË ADMINISTRIMIT TË FORMATIT TË REGJISTRIT
TË TRANSFERTAVE INDIVIDUALE DHE TË REGJISTRIT KOMBËTAR TË
TRANSFERTAVE, SI DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjës "d" të nenit 28 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe të pikës 19 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.6.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre",

URDHËROJ:

1. Regjistri i transfertave individuale të mbetjeve të rrezikshme mbahet nga dorëzuesi dhe marrësi i mbetjeve të rrezikshme në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, sipas formatit në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Regjistri i transfertave individuale plotësohet për çdo dokument dorëzimi dhe ruhet për një afat 3-vjeçar. Dorëzuesi dhe marrësi i mbetjeve të rrezikshme dërgojnë kopje të regjistrit të transfertave individuale pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dy herë në vit, nga data 1 deri 15 maj dhe nga data 1 deri 15 nëntor.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit krijon Regjistrin Kombëtar të Transfertave të mbetjeve të rrezikshme sipas formatit në shtojcën 2 bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Regjistri Kombëtar i Transfertave të mbetjeve të rrezikshme përditësohet dy herë në vit brenda datës 15 qershor dhe 15 dhjetor.

5. Personi/at përgjegjës për mbajtjen dhe përditësimin e Regjistrit Kombëtar të Transfertave të mbetjeve të rrezikshme caktohen me urdhër të titullarit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit dërgon pranë Ministrisë kopje të Regjistrit Kombëtar të Transfertave të mbetjeve të rrezikshme brenda 10 ditëve pune nga përditësimi i tij.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka

SHTOJCA 1

FORMATI I RREGJISTRIT TË TRANSFERTAVE INDIVIDUAL TË MBETJEVE TË BREZIKSHME

[illegible]

SHTOJCA 2

FORMATI I RREGJISTRIT KOMBËTAR TË TRANSFERTAVE PËR MBETJET E RREZIKSHME[illegible]